REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
02/17
Datë/Datum 05.01.2017

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS, Zyra e Prokurimit, Hyrja Zyrtare Nr. 14, TC Kosova B- Obiliq**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEKO-16-348-521**

Sa i përket tenderit për **Riparimi, liferimi dhe montimi i termoizolimit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INTERING sh.p.k. — *(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*
Prishtinë — *(Vendi)*
10000 — *(Kodi postar)*

+38649767000,+38649767001, +38649767002 — *(Numri Telefonit)*
% — *(Numri i Faks-it)*

Ztr. Xhevdet Shoshi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
intering@interinggroup.com, shefget.avdiu@interinggroup.com, fatmir.kelmendi@interinggroup.com
(Adresa elektronike)

05.01.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

INTERING Industry and Energy Service Velania II Nr.1 PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit) — *(Adresa e plotë)*

(Numri i Telefonit) — *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- **Njoftimi për kontratë me datën 24.10.2016,**
- **Data e dorëzimit te tenderëve me 14.11.2016 ora 13:00,**
- **Hapja publike e tenderëve me datën 14.11.2016 ora 13:30,**
- **Njoftimi për dhënie të kontratës të publikuar në KRPP 23.12.2016**
- **Vendimi për Refuzim Nr. 2796, i datës 30.12.2016, i Kërkesës për Rishqyrtim**
- **Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] Jo [ ]

Nuk kemi pasur vërejtje në hapjen publike të tenderit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

- Kërkesa për Rishqyrtim sipas Nenit 108/A të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve është bërë më: 27.12.2016 (Shiko te bashkangjitur)

- Përgjigja nga KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS, Zyra e Prokurimit: Vendimi për Refuzim Nr. 2796 është pranuar me 30.12.2016 (Shiko te bashkangjitur)

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1: Qëllimi i Ligjit
- Neni 6: Ekonomiciteti dhe efikasiteti
- Neni 7: Barazia në trajtim/jo-diskriminimi
- Neni 59: Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 69: Aftësia teknike dhe/ose profesionale
- Neni 72: Dokumentacioni dhe informatat shtesë
- Neni 108/A: Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- Nenit 39: Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik - Sqarimet e tenderëve nga

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

- Me datën 09.12.2016 përmes e-mailit kemi pranuar shkresën (data e shkresës 08.12.2016), ku kërkohen sqarime në lidhje me dokumentin e parashtruar te OE e të vendosur në dokumentacionin tonë si prodhues.
- Me datën 12.12.2016. kemi dërguar shkresën me përgjigje me shpjegimet se kemi dorëzuar certifikatat nga prodhuesit me renome botërore, si dhe arsyetimin se operatori ekonomik i cili nuk është prodhues nuk mund te disponon certifikate (Shiko te bashkangjitura);
- Me 27.12.2016, kemi dërguar **Kërkesë për Rishqyrtim, s**ipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (Shiko te bashkangjitura);
- Me datën 30.12.2016, kemi pranuar **Vendimin për Refuzim** Nr. 2796, i Kërkesës për Rishqyrtim (Shiko te bashkangjitur);

4

FAKTET DHE ARGUMENTET:

- I vetmi argument te cilin KEK, ofron për eliminonim e Kompanisë INTERING është: *Ju nuk e plotësoni kriterin e kërkuar me nr. III.2.4. Kapaciteti Teknik dhe profesional ne njoftimin për dhënie kontrate dhe ne dosje te tenderit ne nenin 9.2 Kërkesat teknike dhe profesionale, ku kërkohet : Kopja e certifikatës ISO 9001:2008 te prodhuesit për produktet e ofruara.*
- Ne mendojmë se arsyetimi i ofruar nga KEK për eliminimin tone është plotësisht i paqëndrueshëm, dhe ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe me Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik. Këtë kërkesë te KEK-ut, kompania jonë e ka plotësuar 100 %, dhe ne kemi ofruar edhe me shume se sa qe është kërkuar ne këtë pikë me rastin e dorëzimit te ofertës, si dhe me rastin e dërgimit te shkresës për Sqarime Shtesë me datën 12.12.2016. Ne së bashku me oferten tonë për këtë tender kemi dorzuar çertifikatat ISO 9001 të prodhueseve Knauf, ThyssenKrupp, SabProfile, Tata steel që mendojmë se është më shumë se që është kërkuar në dosjen e tenderit. Ndërsa sqarojmë se Tacke Lindemanm është kompani furnizuese-distributore Gjermane me reputacion të lartë i materialeve në fushën e kërkuar dhe i materialeve të prodhuesve të dhënë ne tabelën "Pjesa-III"- prejardhja e mallrave. Por është edhe fakti tjetër se me mos marrjen në konsideratë të Tacke Lindemann në tabelën 'Pjesa III" nuk ndryshon kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë dhe përmban devijim të vogël që nuk shkakton devijime nga karakateristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. (Ankesës i bashkëngjiten te gjitha korrespondencat e Kompanisë "INTERING" me KEK lidhur me këtë tender.

KEK me rastin e eliminimit te Kompanisë sonë dhe Dhënie te Kontratës OE te dyte me radhë për nga Çmimi, ka vepruar ne kundërshtim me:

- Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët përcaktuar ne Njoftimin për Kontrate: IV.2) KRITERET E DHËNIES;

- Neni 1: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen

dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

- Neni 6.1 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. AK ne këtë aktivitet te prokurimit ka dëmtuar buxhetin për 3.733,52 €, (113,027.48€ - 109,293.96€) e kur te kihet para sysh se kontrata është kornize kjo mund te jete edhe 30 % me e madhe. AK – KEK me rastin e Dhënies se Kontratës ka shpallur fitues OE AR TECH sh.p.k& IZOVENT nnsh, derisa ne Hapje te ofertave ky OE është i regjistruar ne Procesverbalin e Hapjes vetëm me emrin AR TECH sh.p.k. Mendojmë se kjo është devijim më i madh e Ligjit te cilin KEK e ka pranuar se sa Arsyetimi ne eliminimin e kompanisë sonë, i cili nuk mund te rangohet as ne devijimet minore. (*Neni 59.4: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve).*

- Neni . - Barazia në trajtim/jo-diskriminimi: Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. AK KEK, gjate vlersimit te tenderëve ka diskriminuar Kompaninë INTERING duke shpallur fitues OE me çmim me te lartë. Mendojmë se INTERING është Operator ekonomik me i përgjegjshëm ne te gjitha aspektet se sa OE i shpallur fitues. Ne baze te nenit Neni 10.3 te LPP kemi bere kërkesë AK KEK për qasje të arsyeshme në të dhënat e përshkruara në piken 1, e cila na është lejuar prandaj kërkojmë nga Eksperti dhe Paneli Shqyrtues verifikimin e datave të vlevshmërisë të çertifikatave ISO 9001, dhe verifikimin e referencave të operatorit të shpallur fitues si dhe a janë të natyrës të kërkuar në dosjen e tenderit.

- Neni 59.1. - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Duke u bazuar ne këtë kërkesë ligjore i

propozojmë OSHP, qe te kërkon përgjegjësi nga anëtaret e komisionit vlerësues, si dhe nga Menaxheri i Prokurimit i cili ka pranuar rekomandimin e komisionit vlerësues.

- Neni 69 - Aftësia teknike dhe/ose profesionale: Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkese, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen. Mendojmë se OE INTERING, i ka plotësuar ne plotësi kërkesat e këtij neni dhe kërkesat e përcaktuara ne Dosjen Tenderike lidhur me Aftësitë teknike dhe profesionale

- Neni 72 - Dokumentacioni dhe informatat shtesë: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Mendojmë se OE INTERING ne përputhje me ketë nen i ka dorëzuar AK KEK te gjitha dokumentet e kërkuara, por AK nuk i ka trajtuar keto në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

- Neni 39 – Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik - Sqarimi i Tenderëve: 39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. Tabela ne këtë nen ne Rendin 9: **Mungon certifikata ISO: Mund te kërkohen informata sqaruese**. AK -KEK nuk e ka zbatuar ne mënyrë te drejte këtë kërkesë te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, pasi që sipas kërkesës së AK, ne kemi ofruar sqarimin e duhur , gjë që AK – KEK nuk e ka parë të arsyeshme ta pranojë.

- Neni 108/A.2. - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve: Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar. AK KEK, nuk ka zbatuar drejt kërkesat e këtij neni. Ka bëre Njoftimin për Dhënie te Kontratës pa i kryer me radhë të gjithë hapat e këtij neni. Duke pasur para sysh Nenin 44.12 - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik: Pavarësisht nga ajo që është cekur më sipër, AK do të anulojë një Njoftimi për dhënie të kontratës, nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP", rekomandohet nga

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik "KRPP", atëherë ne kemi kërkuar se KEK nuk mund te ndryshoj Rekomandimin për Dhënie te Kontratës, por me qellim qe te përmbushim kërkesën formale te Nenin 108A te LPP, për ti drejtuar ankesën OSHP.

Duke u bazuar ne te dhënat e cekura me larte, kërkojmë nga Eksperti(tët) Shqyrtues dhe Paneli i OSHP-se:

- Te shqyrton te gjitha pretendimet e ankesës sonë, te bien Vendimin meritor duke u bazuar ne faktet dhe argumentet e konstatuara, si dhe te kërkon nga AK KEK, eliminimin e shkeljeve te bëra gjate vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Dëmi kryesor i cili i është shkaktuar OE INETRING, mendojmë se është ulja e kredibilitetit, duke pasur para sysh se kompania jone për një kohe te gjate ka pasur raporte mjafte te mira bashkëpunimi me KEK;
- Shpenzimet e resurseve humane dhe financiare për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës dhe te sigurisë së tenderit;

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*